



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-021
Prishtinë, më 13 maj 2015, në orën 13:20
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 13 MAJ 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë nëpërmjet së cilës ka kërkuar mbajtjen e kësaj mbledhjeje të Kryesisë.

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Grupit parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme të Kuvendit lidhur me ngjarjet e fundit në Kumanovë (Maqedoni).

Lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme diskutuan: Aida Dërguti, Sabri Hamiti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartpërmendura, Kryesia konstatoi se kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në fund, Kryesia konstatoi se parashtruesi i kësaj kërkesë në fillim të seancës, më 14 maj 2015, mund të propozojë që Kuvendi ta shqyrtojë menjëherë si çështje urgjente për të cilën vendos Kuvendi.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale